



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 470/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Fushë Kosovë.

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se me datë 03.11.2013 rreth orës 14:00 në magjistralen Pejë-Prishtinë në Fushë Kosovë, pranë rrethit, ka ardhur një veturë e markës Mercedes me targa 01736CK, dhe u parkua përball zyrave të PDK-së në Fushë Kosovë. Në këtë veturë ishin të vendosur fotografit e kandidatit për kryetar të komunës nga LDK-ja si dhe flamujt partiak. Parashtruesi i ankesë pretendon se është shkelur ligjin Nr.03/L-073, si dhe nenin 36 pika b), thuhet në ankesë, se rasti është konfirmuar edhe nga policia lokale.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet e parashtruesit të ankesë nuk qëndrojnë, ngase parashtruesi i ankesës, nuk ka ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenit 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 470/2013 më datën 06.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*